



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHENDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QENDRA SHENDETËSORE E SPECIALITETEVE PASKUQAN

**Data: 30.04.2024**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi imallrave</b>	<b>Njësia</b>	<b>Specifikime</b>	<b>Sasia</b>
1	Glukoze	ml		800
2	Kolesterol	ml		800
3	Trigliceride	ml		800
4	AST	ml		700
5	ALT	ml		700
6	Bilirubinetotale	ml		2500
7	Ure	ml	ml	420
8	HBA1C	teste	1x25teste	1600
9	Tromboplastine	ml	Kite (1x20 ml)	200
10	PCR (sasiore)	ml	kite	240
11	ALP	ml		280
12	FR(sasiore)	ml		300
13	Proteine totale	ml	ml	2500
14	Zhgut tub	cope		10
15	Dermografe	cope		50
16	ASO	ml		50
17	Amilaze	ml		40
18	LDH	ml		280
19	Sodium sulfat anhider	kuti	kuti	1
20	Gota urine	cope		3000
21	Tuba urine	cope		3000
22	Stativ urine	cope		4
23	Tuba K3 EDTA 1(ml)	cope		5500
24	Stripe urine	cope	30 kuti x100	3000
25	Tampon strishovaginale	cope		100
26	Tuba tethjeshte	cope		8700
27	Kuti me lama	kuti		50

28	Lamela	kuti		10
29	Calcemia	ml		640
30	Gama GT	ml		280
31	Kyveta Clot 2S	cope	1x250ml	1600
32	Acid urik	ml	1x125 ml	480
33	M-52 Diluent( EN/20 l x 1)	kite	1x500ml	10
34	M-52 Diff- Lyse( EN	kite		15
35	M-52 LH Lyse	kite	1x120ml	15
36	Probe cleanser(M-68/En)	kite		7
37	Tuba ERS	cope		1500
38	Pipeta ERS	cope		1500
39	Statv ERS	cope		4
40	Tuba me xhel	cope		7000
41	Tuba citrat koagulimi	cope		1900
42	Grup gjaku(A/B/0)	kite		1
43	Maja te Verdha	cope		4000
44	Maja te Bardha	cope		2000
45	Maja Blu	cope		5000
46	CD 80 Alkaline cleaning solution	kite	1 kit x 1l	17

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**33696200-7 Reagente per analizat e gjakut**

**REF-03089-04-30-2024**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5,392,809 (pese miljon e treqind e nentedhjete e dy mije e teteqind e nente ) leke pa tvsh.**

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor: Poliklinika e Specialiteteve Nr.4 ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Dokumentat si më poshtë:

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht për lotin e dyte në vlerën 10,658.6 leke*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme.

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatori ekonomik duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% të fondit limit.

Kërkesa përplotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë vitit të fundit, 2023. *Per të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 1(një) viti të fundit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin e kërkuar 2023, nuk ka raport negativ, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" I ndryshuar; në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

e ndryshuar dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve te ankesave, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

### **2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.3.2** Kërkohet deklarate e ofertuesit; per plotësimin e afatit te skadences se tyre, si dhe respektimit te specifikimeve teknike te kërkuara nga shërbimi i Laboratorit per secilin artikull.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim te leshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i Autorizuar/MAH/(ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet te cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje Kitet dhe Reagentet objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave; dhe origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbi kërkesën e autorizimit të prodhuesit është konform VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfutuesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*”, dhe nese operatori ekonomik ofertues eshte prodhues I pajisjeve mjeksore duhet te paraqese çertifikatën **SSH EN ISO 13485:2016**“*Sistemet e menaxhimit të cilësisë* per pajisjet mjeksore “ose **EN ISO 13485 :2016** “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë* per pajisjet mjeksore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Ne rast se OE, ofertues, nuk eshte prodhues duhet te paraqese nje vetdeklarim qe ne kete rast Furnizuesi eshte konform standarteve te cilesise. AK, rezervon te drejten e verifikimit te vetdeklarimit ne procesin e vleresimit te dokumentacionit. Ne rsat kur OE, kualifikohet I pari duhet te paraqese prane AK, certifikaten.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë se i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

*ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autodeklarate për Kitet dhe Reagentet nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat **MDD 93/42/EEC** ose **98/79 EC**, ose **2015/1535/EU**, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave perkatëse **CE/DC (Deklarate konformiteti)** ose **FDA** origjinale, ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara, të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77 pika 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1 inxhinier të diplomuar në profilin Inxhinieri Elektronike/ Elektrike/ Mekanike/ Informatike/ Mjekesore, gjithashtu të jetë i trajnuar për pajisjet laboratorike pasi do të jetë përgjegjës për instalim, trajnim të stafit mjekësor dhe kalibrimin e marterialeve.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse si dhe listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit për vetëdeklarimet mbi punonjësien e kërkuar në DST.

**Argumentimi:** Kërkesa është hartuar në përputhje me pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 paragrafet b dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si më lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë

dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës i referohet pikës 1 dhe pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për 1 (një) inxhinier të diplomuar në profilin Inxhinieri Elektronike/ Elektrike/ Mekanike/ Informatike/ Mjekesore, gjithashtu të jete i trajnuar për pajisjet laboratorike pasi do të jete përgjegjës për instalim, trajnim të stafit mjekësor dhe kalibrimin e marterialeve, lidhet me domosdoshmërinë për prezencën në stafin e OE të një profesionisti që është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të procesit. 1 (një) inxhinier, duke marrë parasysh kompleksitetin e kontratës, afatet kohore, shumëllojshmërinë e mallrave të kërkuara, do të siguronte që çdo pikë e kërkesave të AK të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të dokumentave të tenderit.

**2.3.8** Operatori/et ekonomik fitues janë të detyruar që të bëjnë kalibrimin e të gjitha kитеve dhe reagenteve që do të sjellin për pajisjet mjekësore që disponon Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 4 Tirane, për këto të paraqesin një deklaratë.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5, 6 të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Mostrat e meposhtem në datën e hapjes së procedurës për artikujt me numër rendor 1,2,3,4,5,6,7,11,12,13,16,17,18,30,33,34,35,36,46.**

**Nese certifikatat dhe deshmitë janë në gjuhë të huaja , duhet të shoqerohen me përkthim në gjuhën shqipe të noterizuar.**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## **2.3 Për kapacitetin teknik:**

**1. Furnizime të mëparshme të ngjashme të realizuara brenda 3 viteve të fundit Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të**



shitjes ku te shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Artikujt me num rendor 33,34,35,36 duhet te jene te pershtatshem me aparatoren cell-counter Mindray BC 5000 ose Ekuivalente.

3. Te gjitha kitet e tjera duhet te jene te pershtatshem per Autoanalizatorin BS 240 ose Ekuivalente

4. Operatori ekonomik Fitues duhet te paraqese Kitet dhe Reagentet te amabalazhuar bashke me Kalibratoret.

5. Operatori ekonomik duhet te paraqese Autorizim Prodhuesi ose Distrubitori per te gjitha Artikujt.

6. Operatori ekonomik duhet te paraqese Mostrat e meposhtem ne daten e hapjes se procedures per artikujt me numer rendor 1,2,3,4,5,6,7,11,12,13,16,17,18,30,33,34,35,36,46.

7. Vertetim nga Prodhuesi per pershtatshmerine e Reagenteve dhe kontrolleve Kalibrim per aparatin BS 240.

8. Operatori duhet te kete inxhinier per Autoanalizatorin BS 240 dhe cell-counter Mindray BC 5000 ose Ekuivalente.

9. Data e skadences duhet te jete 12 muaj nga momenti I marrjes ne dorezim.

10. Operatori duhet te paraqese certefikate Iso te prodhuesit Certifikatë ISO 9001:2015 / ISO 13485:2016 dhe CE per produktet.

11. Operatori ekonomik duhet te paraqese ISO 9001:2015 / ISO 13485:2016.

**Njësia e Prokurimit:**

**Ndricim Cani**

**Vjollca Kulici**

**Gjustina Loloci**